



NJOFTIM

1. Kriteret e pranimit të kandidatëve për studime në Shtetet e Bashkuara të Amerikës:

- Të ketë shtetësi shqiptare.
- Të ketë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë ose në raste të veçanta të jetë në vitin e fundit të studimeve parauniversitare.
- Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë.
- Të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 22 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik (shtator 2020).
- Të mos jetë i martuar.
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore.
- Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen.
- Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 170 cm për meshkujt dhe jo më pak se 165 për femrat.
- Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme) të tjera; të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zëmres, veshkave, hepatiche, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose jetë përdorues i lëndëve narkotike.
- Kandidatët që do të aplikojnë për ndjekjen e studimeve në Akademitë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës të plotësojnë kriterin e notës mesatare të shkollës parauniversitare, jo më pak se 6.5 (gjashtë pikë pesë).
- Kandidatët duhet të zotërojnë gjuhën angleze në të lexuar, të shkruar e të folur dhe të sigurojnë mbi 70 pikë në testimin ALCPT. Ata duhet të jenë regjistruar për zhvillimin e testeve online të TOEFL dhe SAT ose ACT.
- Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se:
 - a. Zotërojnë diplomë ushtarake për nivelin arsimor për të cilin aplikojnë;
 - b. Kanë fituar më parë statusin e studentit ushtarak;
 - c. Kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar studimet.
- Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, s'kualifikohet.

2. Regjistrimi i kandidatëve, dokumentacioni i nevojshëm:

- Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve në Akademitë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
- Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me certifikatën dhe listën e notave.
- Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar që vërteton se ndjek vitin e fundit të studimeve parauniversitare, si dhe listën e notave të vitit të parë, vitit të dytë dhe semestrit aktual.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Fotografi për dokument (4x6), 2 (dy) copë.
- Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit.
- Dokument i cili vërteton se aplikanti është regjistruar për testimet që zhvillohen online në TOEFL dhe SAT ose ACT.
- Certifikatë të TOEFL, SAT ose ACT nëse ka.
- Raport mjekësor të lëshuar nga komisioni mjekoligjor (KML) i qendrës shëndetësore të vendbanimit të kandidatit shoqëruar edhe me një raport ose vërtetim nga mjeku i familjes ku deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje infektive dhe të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale të jetës.
- Ekzaminimet mjekësore për agjentë infektiv (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë.
- Formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë Qendrës së Personel Rekrutimit në momentin e dorëzimit të dokumentacionit.

Periudha e regjistrimit të kandidatëve deri më 03/12/2019.

Adresa: Qendra e Personel Rekrutimit, Rruga e "Dibrës" (Ish-Shkolla e Bashkuar), Tiranë.

Kontakt: + 355 42 348 588 Facebook: Qendra e Personel Rekrutimit **<http://www.mod.gov.al>**